

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje kompjutera dhe printera”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): desktop,
printera**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 3 437 632(tremilion katërqind tridhjetë e shtatë mijë e
gjashtëqind e tridhjetë e dy) pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale :

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit të kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa 40% e fondit limit që prokurohet.

(Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2,c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros se përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohej për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve për 3 vitet e fundit (**2020, 2021 dhe 2022**) të konfirmuara nga autoritetet perkatese. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per procedurën e hapur të thjeshtuar është përcaktuar se vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë sa 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Te kete ne stafin e tij te pakten 1 (një) inxhinier elektronik me diplomim universitar me master ose ekuivalent, me përvojë të paktën 2-vjeçare në fushën e pajisjeve elektronike. Per te plotesuar kete kriter operatori ekonomik duhet te paraqese te pakten diplomën/diplomat universitare per profesionin e kerkuar per te pakten 1 (nje) punonjes te stafit te tij, CV dhe te pakten listpagesen e muajit me te fundit te deklaruar ne organet kompetente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...

Kerkesa per kete punonjes te kualifikuar behet e nevojshme pasi totalisht produktet e kerkuara jane pajisje TIK dhe per te gjitha kerkohet furnizim-vendosje dhe suport mbeshtetes teknik nga stafi i OE (meqenese mungon ky lloj specialiteti / kompetence te stafi i AK-se) qe te integrohen me sistemet TIK ekzistuese te AK, ne funksion te realizimit me sukses te procedures. Autoriteti kontraktor kerkon sigurine dhe cilesine e duhur qe sistemi TIK te jete sa me i kompletuar, dhe kete e garanton inxhinjeri elektronik me eksperiencon e duhur te tij. Gjithashtu forcon besimin qe do garantohet zbatimi i kushteve te

garancise per te gjithë produktet TIK pas shitjes deri ne afatin e percaktuar ne kontrate, duke mos bllokuar proceset ekzistuese te punes.

2.3.3 Te kete ne stafin e tij te pakten 1 (një) specialist TIK te certifikuar CCNP ose ekuivalent, per instalim/konfigurim rrjeta/pajisje kompjuterike qe kane funksione IP/Lan, me pervojë të paktën 1-vjeçare në fushën perkatese. Per te plotesuar kete kriter operatori ekonomik duhet te paraqese te pakten çertifikaten e kualifikimit te vlefshme te pakten ne ditën e hapjes se prokurimit, CV dhe te pakten listpagesen e muajit me te fundit te deklaruar ne organet kompetente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...

Kerkesa per kete punonjes te kualifikuar behet e nevojshme pasi totalisht produktet e kerkuara jane pajisje TIK dhe per disa prej tyre (switch dhe pajisjet printuese qe kane funksionalite dhe nderfaqesim rrjeti IP/Lan) kerkohet furnizim-vendosje dhe suport mbeshtetes teknik nga stafi i OE (pasi mungon ky lloj specialiteti / kompetence te stafi i AK-se) qe te instalohen ne rrjet/lan dhe te integrohen me sistemet TIK ekzistuese te AK, ne funksion te realizimit me sukses te procedures. Autoriteti kontraktor kerkon sigurine dhe cilesine e duhur qe ne teresi pajisjet TIK te lidhen me sistemin TIK ekzistues, dhe kete e garanton specialisti i certifikuar CCNP me kompetencat e tij. Gjithashtu AK forcon besimin qe do garantohet zbatimi i kushteve te garancise per te gjithë produktet TIK, te pakten per periudhen e garancise si dhe do garantoje konsulencen e duhur per rastet e azhornimeve te sistemeve qe afektojne lidhjen/nderveprimin me keto pajisje printuese.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te paraqese autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar nga prodhuesi per te gjithë produktet, ku te autorizohet operatori per shitjen ne territorin e Shqiperise. Ne rast te paraqitjes se autorizimit te distributorit, te vertetohet lidhja tregtare mes prodhuesit dhe distributorit dhe te jete e vlefshme e pakten ne ditën e hapjes se prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Ky kriter vendoset në përputhje me piken 6/B dhe 8 të nenit 40 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **lidhur me autorizimet**, dëshmitë për fotografitë ose katalogët teknike.

Me ane te ketij kriteri autoriteti kontraktor kerkon te forcoje besimin qe operatori ekonomik i interesuar do te ofroje produkte TIK cilesore dhe origjinale te markave nderkombetarisht te njohura, qe vijne/furnizohen nga kanalet distributive legale zyrtare dhe kane certifikimet e

duhura e te pershtatshme për tu përdorur ne Shqiperi dhe vertetimi i lidhjes direkt me prodhuesin apo me distributorin e autorizuar prej ketij te fundit forcon akoma me shume besimin qe do ofrohen dhe konsultime, nese te nevojshme, gjate procesit te zbatimit si dhe do garantohet zbatimi i kushteve te garancise per produktet TIK pas shitjes, deri ne afatin e percaktuar ne kontrate, duke mos bllokuar proceset ekzistuese te punes.

2.3.5 Operatori duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtëme:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën per menaxhimin e cilesise **ISO 9001:2015** ose ekuivalente me të, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen;
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën per menaxhimin e shërbimeve **ISO 20000-1: 2011/8** ose ekuivalente me të, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen;
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën per menaxhimin e informacionit **ISO 27001:2013** ose ekuivalente me të, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen;

Çertifikatat e mesiperme duhet te jene te vlefshme te pakten ne ditën e zhvillimit te ketij prokurimi.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me piken 1 te nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione te autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Ky kriter, meqenese kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose ofertuesit, është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale dhe të cilësisë nga OE pjesëmarrës si dhe eshte proporcional me kete objekt pasi totalisht mallrat jane te natyres TIK.

Ne piken 1 te nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” percaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose*

organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi **ISO 9001** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësive implementuese, meqenëse është edhe furnizim-vendosje dhe integrim me sistemin ekzistues.

Certifikimi **ISO 27001** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara, si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar, dhe kjo kërkon kompetencë të shtuar profesionale në këtë drejtim, meqenëse është edhe furnizim-vendosje dhe integrim me sistemin ekzistues.

Certifikimi **ISO 20001-1:2011** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjive të informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të zbatohet të gjithë sistemin në teresi i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK, meqenëse është edhe furnizim-vendosje dhe integrim me sistemin ekzistues.

2.3.6. Për vlerësimin e sakte të ofertës teknike, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë fizikisht, në datën dhe orën e hapjes së ofertave moster të pajisjeve/komponenteve:

Nr rendor	Përshkrimi
1	F.V Kompjuter Desktop 1
2	F.V Kompjuter Desktop 2
3	F.V Kompjuter Workstation (Sipas Prodhuesit)
4	Printer B&M Advanced

Mosparaqitja e mostrave ose mosperputhja e parametrave teknik te tyre me specifikimet e kerkuara eshte kusht skualifikues.

Mostrat do jene konfidenciale per secilin operator ekonomik.

Mostrat do te dorezohen ne zyren e prokurimeve te Autoritetit Kontraktor ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar dhe në përputhje me piken 6/a të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me autorizimet, dëshmitë për fotografitë ose katalogët teknike. *Ku thuhet :*

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Tre produktet e kerkuara si moster ne sasine 1 cope/secili, ne fazen e dorezimit te ofertave nga autoriteti kontraktor rezultojne lehtesisht te gjetshem ne tregun shqiptar dhe per AK eshte nje kriter qe perforcon bindjen ne specifikimet teknike te sakta, cilesine dhe origjinalitetin e produkteve qe do ofrojne dhe realisht do dorezoje operatori ekonomik fitues.

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	7900 Pikë
"RAM":	8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
Madhësia e Solid-state Drive "SSD Size":	500 GB SSD
"Disk Subsystem Controller":	Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike "Graphics":	Integrated graphic Card, min. 1 GB
"Media Device":	DVD+/-RW
"Slots":	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit "Ports":	Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA
Rrjeti "Networking":	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
"Sound":	Integrated Sound Card
"Speakers":	Internal or Built-in Monitor
Siguria "Security Management":	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit "Preinstalled Licensed O. S.":	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera "Keyboard":	Standart Keyboard QWERTY
"Mouse":	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi "Power Supply"	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë "Energy Efficiency":	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
"Recover":	Recover Partition
MONITORI	
Tipi "Type":	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia "Size":	≥ 21"
Rezolucioni "Native Resolution":	1920 x 1080 at 60 Hz
Raporti i Kontratit "Contrast Ratio Static":	1000:1
"Display Port":	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit "Response Time":	≤ 6 ms
Kursimi i Energjisë "Energy Efficiency":	Energy Star
Ushqimi "Power Supply":	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	3 Vjet

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	11500 Pikë
"RAM":	8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
Madhësia e Solid-state Drive "SSD Size"	500 GB SSD
"Disk Subsystem Controller":	Serial ATA III 6.0 Gb/s
Karta Grafike "Graphics":	Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 2 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor)
"Media Device":	DVD+/-RW
"Slots":	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit "Ports":	Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor)
Rrjeti "Networking":	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
"Sound":	Integrated Sound Card
"Speakers":	Internal or Built-in Monitor
Siguria "Security Management":	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit "Preinstalled Licensed O. S.":	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera "Keyboard":	Standart Keyboard QWERTY
"Mouse":	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi "Power Supply":	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë "Energy Efficiency":	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
"Recover":	Recover Partition
MONITORI	
Tipi "Type":	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia "Size":	≥ 21"
Rezolucioni "Native Resolution":	1920 x 1080 at 60 Hz
Raporti i Kontrastit "Constrast Ratio Static":	1000:1
"Display Port":	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit "Response Time":	≤ 6 ms
Kursimi i Energjisë "Energy Efficiency":	Energy Star
Ushqimi "Power Supply":	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	3 Vjet

KOMPJUTERA

Workstation (Sipas Prodhuesit)

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	10000 Pikë
"RAM":	16 GB, min. DDR4-2666 MHz, ECC
Madhësia e Hard Diskut "HDD Size":	(1) x 256 GB SSD Sistemi Operativ dhe (2) x 1000 GB HDD
Shpejtësia e Hard Diskut "HDD Speed":	7200 RPM SATA 6.0 Gb/s për HDD
"Disk Subsystem Controller":	Serial ATA III 6.0 Gb/s, Minimum 4 Serial ATA Interface with RAID 0,1,5,10 Support. (Hard Disk të Konfiguruar në RAID 1)
Karta Grafike "Graphics":	Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Min. 2 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për workstation.
"Media Device":	DVD+/-RW with Dual Layer DVD+R wri. Capacity
"Slots":	Minimum (4) PCI/PCI-E nga të cilat min. (2) PCI-E x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit "Ports":	Min. (8) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (6) USB 3.0 (2) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor)
Rrjeti "Networking":	(2) 10/100/1000 LAN Gigabit Ethernet Port
"Sound":	Integrated Sound Card
"Speakers":	Internal speakers or Built-in Monitor
Siguria "Security Management":	Embedded Security TPM 2.0
Sistemi i Operimit "Preinstalled Licensed O. S.":	OEM Windows 10 64-bit Professional për Workstation
Tastiera "Keyboard":	Standart Keyboard QWERTY
"Mouse":	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi "Power Supply":	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë "Energy Efficiency":	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
"Recover":	Recover Partition
MONITORI	
Tipi "Type":	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia "Size":	≥ 23"
Rezolucioni "Native Resolution":	1920 x 1080 @ 60 Hz
Raporti i Kontrastit "Constrast Ratio Static":	1000:1
Koha e Rifreskimit "Response Time":	≤ 6 ms
"Display Port":	(1) VGA ose DVI dhe (1) prej Portave DP/DVI/HDMI
Kursimi i Energjisë "Energy Efficiency":	Energy Star
Ushqimi "Power Supply":	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	3 Vjet

AKSHI Standardet Teknike për pajisjet elektronike për përdorim zyre

25

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Shpejtësia e Printimit " Print Speed" A4:	≥ 45 ppm
Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle":	60 000 Faqe
Teknologjia "Technology":	Laser
Rezolucioni i Printimit Minimal "Print Quality":	1200x1200 dpi
Kapaciteti në Hyrje "Input Capacity"	500 Fletë
Pesha Specifike e Letrës "Media Sizes":	60-120 g/m ²
Formati i Letrës "Media format":	A4/A5/Envelope
Aftësia e Printimit Duplex:	Po
Memorja "Memory":	≥ 256 MB
"Toner":	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit "Interface":	High Speed USB 2.0
"Ethernet":	Po
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
Software/Drivers CD :	Po
Kabëll USB:	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	2 Vjet
Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.	

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë teknologjitë ekzistuese dhe nevojat për funksionalitet cilesi e performance të sistemeve informatike të Autoritetit Kontraktor, të kërkuar nga ky i fundit, duke pasur parasysh dhe pajisjet e tjera TIK që AK kanë përdorim në ambientet e tjera të ngjashme, në mënyrë që të përputhen sipas objektit të procedurës së prokurimit, duke saktësuar karakteristikat e duhura, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke kërkuar garancite perkatëse të këtyre produkteve që formojnë në vetvete një sistem informatik bashkëkohor, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Është përdorur termi “ose ekuivalent” për të qenë gjithmone në konformitet me zbatimin e legjislacionit të prokurimeve publike dhe akteve nën-ligjore në zbatim të tyre.

Më pas u vendos për këto çështje:

Vlefshmëria e ofertës 150 ditë.

Kriteret e vlerësimit: Është çmimi më i ulët i ofruar.

Afatet e ekzekutimit, janë 7 dite nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

Komisioni unanimisht bëri miratimin e tyre dhe u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave, në Sistemin Elektronik.

NJESIA E PROKURIMIT

ANILA VJERI

ANXHELA BEQIRI

ENDRIN LLANAJ